

VENDIM
Nr.782, datë 10.11.2011

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR, PËR ORGANIZIMIN E
VEPRIMTARIVE FESTIVE PËR “VITIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË
SHQIPËRISË”

(Ndryshuar me VKM nr. 862, datë 19.12.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Shtetëror, për organizimin e veprimtarive festive për “Vitin e 100– vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.

2. Ky komision të kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

a)	Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme;
b)	Ministrin e Financave;
c)	Ministrin e Mbrojtjes;
ç)	Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
d)	Ministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
dh)	Ministrin e Brendshëm;
e)	Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
ë)	Ministrin për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit;
f)	Kryetarin e Akademisë së Shkencave;
g)	Drejtorin e Përgjithshëm të Arkivave të Shtetit;
gj)	Drejtorin e Bibliotekës Kombëtare;
h)	Drejtorin e Qendrës së Studimeve Albanologjike;
i)	<i>Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë.</i>

Me ftesë të kryetarit në këtë grup ftohen të marrin pjesë edhe:

- Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës;
- Zëvendëskryeministri shqiptar i Republikës së Maqedonisë;
- Një përfaqësues i shoqatës kulturore “Vatra”;
- Një përfaqësues i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan (NAAC);
- Një përfaqësues i shqiptarëve të Malit të Zi dhe arbëreshëve të Italisë.

3. Komisioni të marrë të gjitha masat për hartimin e planit të veprimit dhe kalendarin e festimeve, si dhe të përcaktojë llojet e veprimtarive festive, në kuadër të vitit jubilar “Viti i 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.

4. Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të krijojnë nënkomisionet e veçanta, sipas fushave, për organizimin e veprimtarive gjatë gjithë vitit jubilar.

5. Komisioni mblidhet me kërkesë të kryetarit dhe sa herë që shihet e nevojshme.

6. Ngarkohen të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të komisionit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha